



PK. SH.A.
Posta e Kosovës SH.A.
Post of Kosovo J.S.C.
Pošta Kosova D.D.
Nr./No./Br. 01-346/25
Data/Date/Datum 25-02-2025
PRISHTINE-PRISTINA-PRISTINA

Në bazë të nenit 82 paragrafi 3 pika 3.1 e Rregullores nr.01-3060/24 e datës 31.12.2024 për Rregullimin e Marrëdhënies së Punës, Kryesuesi përmes Bordit të Drejtorëve të Ndërmarrjes Publike Qendrore “Posta e Kosovës” Sh.A. në konform Formularit/Procesverbalit nr.01-310/25 të datës 18.02.2025 mbi plotësimin e kriterëve të konkursit nr.01-44/25 të datës 13.01.2025, më datë 25.02.2025 mori këtë:

V E N D I M

1. Anullohet konkursi nr.01-44/25 të datës 13.01.2025 për pozitën e punës Zyrtar/e Kryesor/e i/e Financave dhe Thesarit në NPQ “Posta e Kosovës” Sh.A.
2. Vendimi hynë në fuqi menjëherë.

Arsyetim

Bordi i Drejtorëve kishte shpallur konkursin nr.01-44/25 të datës 13.01.2025 për pozitën e punës Zyrtar/e Kryesor/e i/e Financave dhe Thesarit, i cili kishte qenë i hapur nga data 13.01.2025 deri më datë 12.02.2025.

Pas mbylljes së konkursit, Bordi i Drejtorëve konform nenit 82 paragrafi 3 të Rregullores nr.01-3060/24 të datës 31.12.2024 për Rregullimin e Marrëdhënies së Punës, ka shqyrtuar aplikacionet e kandidatëve që kanë aplikuar në konkurs dhe sipas Formularit nr.01-310/25 të datës 18.02.2025 ka konstatuar që në këtë konkurs kanë aplikuar gjithsej gjashtë (6) kandidatë ku asnjëri nga kandidatët që ka aplikuar nuk ka plotësuar kriteret e konkursit. Të gjithë kandidatët janë njoftuar për mos përmbushje të kriterëve të konkursit dhe iu është dhënë mundësia që në afat prej 3 ditëve të paraqesin vërejtjet e tyre, andaj dhe konform nenit 83 paragrafi 3 pika 3.1 e Rregullores nr. nr.01-3060/24 e datës 31.12.2024 për Rregullimin e Marrëdhënies së Punës, u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

Kryesues i Bordit të Drejtorëve

Gëzim Paço
Posta e Kosovës SH.A.
PK. SH.A.
PRISHTINË
PRISTINA
PRISTINA
Post of Kosovo J.S.C. Pristina

KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij vendimi pala e pakënaqur mund të ushtrojë padi në afat prej 30 ditëve në Gjykatën Themelore në Prishtinë.